# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-449036**

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Dënimi me 81 vite burg për krerët e UÇK-së, Ali Ahmeti: Kosova luftoi për liri, shpresë tek vendimi i Apelit |
| ADRESA | `https://piranjat.al/kosova/denimi-me-81-vite-burg-per-kreret-e-uk-se-ali-ahmeti-kosova-luftoi-per-li-i104427` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 11:58:29 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 16 shtator 2026, 11:41:49 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `be80c08a2643365f6c31096cd52fc43136d02a7217335fc4cf229d6be5c60bde` |
| TEKSTI | `155e7cf09557cd3cbf3f4b12b814b04f5ee4931f247a4224355a6c1c9f0d6782` |
| PAMJA | `c45e6b6b223e989776466ab8b005f218c3ff494e7bc05e25c8b510be9865ec2b` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `44c8338c0af4761e07e16471649016130852e0d2408dd258d599604c8519f1e1` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `aa4643f280403755043cdd17fa8b750c8d4cc9789c755656633151c3e6ad021e` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/44c8338c0af4761e07e16471649016130852e0d2408dd258d599604c8519f1e1`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

KOSOVA

# Dënimi me 81 vite burg për krerët e UÇK-së, Ali Ahmeti: Kosova luftoi për liri, shpresë tek vendimi i Apelit

Piranjat Përditësimi i fundit 16 Shtator 2026, 13:41



Ish-kryeministri e ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, dhe ish-krerët e tjerë të UÇK-së janë dënuar me një total prej 81 vitesh burgim nga Gjykata Speciale në Hagë.

Vendimi ka nxitur reagime të shumta në Kosovë dhe më gjerë, ndërsa mes tyre ka reaguar edhe kreu i BDI-së, Ali Ahmeti. Në postim, Ahmeti e cilësoi vendimin si të padrejtë dhe shprehu zhgënjim për dënimin e Thaçit, Jakup Krasniqit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit.

Ai u bëri thirrje qytetarëve për maturi dhe unitet, duke theksuar se UÇK-ja luftoi për lirinë e Kosovës e se duhet pritur edhe vendimi i Apelit. Ahmeti tha gjithashtu se procesi gjyqësor nuk e mbështeti akuzën për trafikim organesh dhe se të akuzuarit u shpallën të pafajshëm për krime kundër njerëzimit.

*Vendimi i sotëm ndaj Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit është një vendim që e konsideroj të padrejtë dhe thellësisht zhgënjyes.*

*Në këto momente të rënda, bëj thirrje për maturi dhe unitet. Nuk duhet të biem në asnjë grackë që synon të krijojë tensione, përçarje apo të njollosë luftën çlirimtare të popullit në Kosovë.*

*UÇK-ja lindi si përgjigje ndaj shtypjes dhe luftoi për lirinë e Kosovës. Pretendimet e dikurshme për trafikim organesh, që rënduan për vite mbi UÇK-në dhe drejtuesit e saj, nuk u shndërruan në akuza në këtë proces. Po ashtu, sot Gjykata i shpalli të pafajshëm të akuzuarit për krime kundër njerëzimit; dhe potencoi se UÇK kishte pasur objektiv pavarësine e Kosovës, objektiv ky që edhe u arrit. Këto janë fakte që duhet të kujtohen sa herë që dikush përpiqet ta paraqesë UÇK-në si ndërmarrje kriminale.*

*Aktakuza i ngarkonte Thaçin, Krasniqin, Veselin dhe Selimin me përgjegjësi për një sërë krimesh të pretenduara gjatë viteve 1998-1999. Besojmë se edhe këto akuza do të rrëzohen në procesin e mëtejshëm gjyqësor, ashtu siç nuk u materializuan pretendimet e dikurshme për trafikim organesh.*

*Procesi nuk përfundon këtu. Besojmë se mbrojtja do ta vazhdojë betejën juridike në Gjykatën e Apelit, duke kundërshtuar gjetjet e shkallës së parë dhe duke kërkuar drejtësi deri në fund.*

*Lufta e UÇK-së ishte luftë për liri. Historia e Kosovës nuk mund të rishkruhet dhe sakrifica e një populli të tërë nuk mund të vihet në bankën e të akuzuarve.*

*Me besim në drejtësi, beteja vazhdon në apel*

## Artikuj te sugjeruar

KOSOVA 16 Shtator13:40

**Gjykata Speciale dënoi Thaçin më shumë se Serbia, Haga i dha 25 vite, Milloshevіçi e kishte dënuar me 10 vite në qeli**

Gati tri dekada para dënimit me 25 vjet burgim nga Dhomat e Specializuara në Hagë, Hashim Thaçi ishte dënuar në mungesë e...

KOSOVA 16 Shtator13:29

**"Serbia vrau mbi 13 mijë persona", Osmani: UÇK ishte betimi i përgjakur i njerëzve të shtypur që donin çlirimin**

Ish-presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka reaguar pas shpalljes së aktgjykimit ndaj ish-krerëve të UÇK-së në Hagë,...

KOSOVA 16 Shtator13:26

**"Padrejtësia më e madhe e këtij shekulli", reagon vajza e Jakup Krasniqit: Unë do të vdes me bindjen në pafajësinë e babait tim**

Pas vendimit të sotëm në Hagë, ka reaguar edhe vajza e Jakup Krasniqit, Gresë Krasniqi. Në një status të publikuar n&...

KOSOVA 16 Shtator13:24

**"Serbia mori goditje", Ben Andoni: Beogradi nuk e pranon realitetin, do ketë Banjska të tjera**

Analisti Ben Andoni, i ftuar në News24 komentoi dënimin me 81 vite burg për komandantët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosov&eu...

KOSOVA 16 Shtator13:22

**Vendimi i Hagës për ish-krerët e UÇK-së, reagon BE, thirrje për përmbajtje: Gjykata të lejohet të vijojë punën pa ndërhyrje**

Bashkimi Evropian ka reaguar pas aktgjykimit të Gjykatës Speciale në Hagë ndaj katër ish-krerëve të Ushtrisë Çl...

KOSOVA 16 Shtator13:02

**Vendimi në Hagë, reagon Organizata e Veteranëve të Luftës: UÇK-ja s'ka qenë kurrë ndërmarrje kriminale**

Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka thënë se UÇK-ja nuk ka qen&e...

KOSOVA 16 Shtator13:01

**"Godita kokën me grushte kur gjykatësi tha 'Në emër të popullit të Kosovës'"/ Avokati i Hashim Thaçit apel: Kuvendi të heqë mbështetjen për tribunalin**

Avokati i Hashim Thaçit, Pierre Prosper, ka reaguar pas shpalljes së vendimit nga Gjykata Speciale në Hagë, duke shprehur kritika të...

KOSOVA 16 Shtator13:01

**Kadri Veseli u dënua me 18 vite burg/ "Dëshmitë s'u paraqitën", avokati: Ditë e keqe për Kosovën! Do të ndjekim procedurat!**

Avokati i Kadri Veselit, Rodni Dikson pohoi se mbrojtja do të reagojë pas vendimit të fundit, duke shqyrtuar procedurat që mund të nd...

KOSOVA 16 Shtator12:59

**"Djemtë dhe vajzat e UÇK-së mbrojtën pragun e shtëpisë"/ Gjyqi në Hagë, LDK thirrje partive: Të bëhemi bashkë! Momenti i vështirë për Kosovën**

Lidhja Demokratike e Kosovës ka reaguar pas aktgjykimit të Gjykatës Speciale në Hagë ndaj ish-udhëheqësve të Ushtris&e...

KOSOVA 16 Shtator12:52

**Dënimi i komandantëve të UÇK-së, jehonë në mediat ndërkombëtare**

Mediat ndërkombëtare kanë shkruar për dënimin me gjithsej 81 vite burg për komandantët e UÇK-së Hashim Tha&cced...

## ME TE VIZITUARAT

BOTA 15 Shtator

**Takimi pikant zgjat shumë dhe përfundon si mos ...**

Një takim seksual tepër i gjatë, një vjedhje parash, një debat midis një eskorte dhe klientit të saj, dhe në fund nj&eum...

POLITIKE 15 Shtator

[“S’ju pje*dh njeri”, Korreshi përplaset me Gogu...]

Ndërsa Korreshi fliste për gjyqtarët me tone të ashpra, ministri Gogu iu drejtua duke i thënë se deputeti i PD ende nuk e ka kup...

AKTUALITET 16 Shtator

[Pagat ndryshojnë strukturë/ Gati gjysma e të pu...]

Një e katërta e të punësuarve që derdhin kontributin e parë me pagë deri në 50 mijë lekë në muaj, nd&eu...

INVESTIGIME 31 Maj14:01

[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik]

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

## video




## Cdo të premte | ? 20:45 | ???? Syri TV

**Çdo të premte | ? 20:45 | ???? Syri TV**




**Çdo të premte | ? 20:45 | ???? Syri TV**




**Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave**





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.